



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 060/01-28018/24
Kaçanik, 29.11.2024

Në mbështetje të nenit 12.2 (d), 40.2 (g) lidhur me nenin 14 dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), në pajtim me nenin 9 të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.08/L-224 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr.06/L-005 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/16 gusht 2023), të nenit 34.5 lidhur me nenin 6.2 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 nëntor 2024, mori këtë:

VENDIM
PËR CAKTIMIN E SHKALLËVE TATIMORE PROGRESIVE NË
PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2025

I. Shkallët tatimore progresive për vitin 2025

1. Me këtë Vendim, caktohen Shkallët tatimore progresive për vitin 2025 për vlerat e pronave në territorin e Komunës së Kaçanikut, sipas vlerës së kombinuar të të gjitha pronave të paluajtshme të tatimpaguesit, si vijon:

- 1.1 Për vlerën e pronave deri në njëqindmijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.10 %**;
 - 1.2 Për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.20%**, plus tatimi nga nën-paragrafi 1.1 të kësaj pike;
 - 1.3 Për vlerën e pronave mbi pesë qind mijë (500,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.30 %**, plus tatimi nga nën- paragrafët 1.1 dhe 1.2 të kësaj pike;
 - 1.4 Për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.40 %**, plus tatimi nga nën- paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3 të kësaj pike; dhe
 - 1.5 Për vlerën e pronave mbi pesë milionë (5,000,000.00) euro **caktohet** shkalla tatimore në lartësinë prej **0.50 %**, plus tatimi nga nën- paragrafët 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të kësaj pike.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës, fillon të zbatohet nga 01 Janar 2025.
 3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Zyra e Tatimit në Pronë.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës; Drejtoria e Buxhetit dhe Financave (përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante); Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli